



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-044

Prishtinë, më 23 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 23 DHJETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Bilall Sherifi dhe Ismet Hajrullahu,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga: OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 dhjetor 2011,
2. Informatë për aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011,
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 dhjetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 13 dhjetor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Informatë për aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011

Kryetari i njoftoi të pranishmit me Informatën për aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2011, të përgatitur nga Departamenti ligjor.

Informata përmbante aktivitetin e Kuvendit, të përmbledhur në 12 pika: Konstituimi dhe zgjedhja e organeve dhe trupave punues; Aktivitetet e Kryesisë së Kuvendit; Seancat plenare të Kuvendit; Aktivitetet e komisioneve parlamentare; Aktiviteti ligjvënës; Aktiviteti i mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve; Interpelancat; Pyetjet parlamentare; Rezoluta, Deklarata dhe Rekomandime; Programi dhe Planet e veprimit; Ratifikime të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe Akte tjera.

Kryetari propozoi që kjo Informatë të plotësohet edhe me këto pika: Marrëdhëniet e Kuvendit me publikun; vizitat e Kryetarit, të nënkryetarëve dhe të deputetëve jashtë vendit; vizitat e delegacioneve të jashtme në Kuvendin e Kosovës dhe bashkëpunimi i Kuvendit me Partnerët, që mbështesin punën e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi Informatën me plotësimet e cekura më lart. Informata, pasi të plotësohet, të publikohet në web faqen e Kuvendit.

3. Të ndryshme

Kryetari i njoftoi të pranishmit me shqetësimet e mediave, që kishin ngritur lidhur me Rregullore për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit të Kosovës. Kryetari theksoi se kjo Rregullore nuk i pengon Mediat që ta përcjellin punën e Kuvendit dhe të trupave të tij punues. Në hartimin e kësaj Rregullore kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Mediave, për të cilët Kuvendi, në

bashkëpunim me OSBE-në, ka organizuar disa vizita në Parlamentet e vendeve evropiane, për të parë praktikat e tyre.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Ardian Gjini, Glauk Konjufca, Xhavit Haliti dhe sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi. Diskutimet e tyre janë dhënë të plota në Transkript.

Në fund, Kryesia ngarkoi Zyrën për Media dhe Marrëdhënie me Publikun që të sqarojë se Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe të publikut në punën e Kuvendit të Kosovës nuk i pengon Mediat që ta përcjellin punën e Kuvendit dhe ta informojnë publikun lidhur me të. Rregullorja ndalon vetëm incizimet dhe fotografimin në Hollin e Kuvendit, në Restaurant dhe kur mbledhjet janë të mbyllura.

Kuvendi në punën e tij, edhe më tej, do të vazhdojë të bashkëpunojë me Mediat dhe Shoqërinë Civile dhe puna e tij do të jetë transparente për qytetarët e Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.